



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 247/13 prot.

Tiranë, më 29 . 5 . 2023

Lënda: Raporti i Monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2023

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Institucionin e Komisionerëve Publikë, për 4-mujorin e parë të vitit 2023. Zbatimi i buxhetit të miratuar për Institucionin e Komisionerëve Publikë është bazuar në drejtimet kryesore të miratuara me vendimet e Mbledhjes së Komisionerëve Publikë dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik, si dhe në parimin e ligjshmërisë, ekonomikitetit, efikasitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve buxhetore. Në vijim paraqitet, në mënyrë të përmbledhur, realizimi i fondeve buxhetore për këtë periudhë, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar.

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor (plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Buxheti 4-mujor (plani)	Realizimi 4-mujor (fakti)	Realizimi në %
Shpenzime korente	88,900	88,900	31,900	28,696	90%
Shpenzime kapitale	1,500	1,500	-	-	-
TOTALI	90,400	90,400	31,900	28,696	90%

Me ligjin nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", u miratua buxheti total vjetor për Institucionin e Komisionerëve Publikë në vlerën 90,200 mijë lekë, i detajuar në 79,400 mijë lekë në shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, 9,300 mijë lekë në shpenzime operative dhe 1,500 mijë lekë në shpenzime kapitale (investime). Gjithashtu, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 2 datë 19.1.2023, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", është miratuar detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023, në vlerën 200 mijë lekë. Për sa i përket buxhetit në paga dhe sigurime shoqërore, fondi i miratuar për vitin 2023 ishte përlllogaritur bazuar në nivelin e pagave sipas akteve ligjore e nënligjore, në kohën e miratimit të ligjit të buxhetit të shtetit, si dhe strukturën organike miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 94/2017, të ndryshuar.

Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese, me Vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, vendosi shfuqizimin e nenit 2, pika 5, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky vendim ka hyrë në fuqi datën e publikimit në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 9.1.2023. Sikurse ju kemi bërë me dije, me shkresat tona nr. 10/12 prot., datë 26.1.2023 dhe nr. 10/16 prot., datë 10.2.2023, prej datës 9 janar 2023, paga referuese bazë për Komisionerët Publikë dhe Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor është përlllogaritur sipas kategorisë së pagës I-b, përfshirë shtesën e pozicionit dhe pagën e grupit. Zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese ka një efekt shtesë në buxhetin e Institucionit të Komisionerëve Publikë, për vitin 2023, në vlerë rreth 8,000 mijë lekë, buxheti i cili, me gjithë kërkesën e paraqitur Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nuk është akorduar ende. Me buxhetin e miratuar për vitin 2023 mund të mbulohen të plota detyrimet për paga dhe sigurime shoqërore për institucionin vetëm për 10 muaj. Gjithashtu, risjellim edhe një herë në vëmendjen tuaj se, në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Institucioni i Komisionerëve Publikë ka përlllogaritur edhe efektet financiare shtesë për korrigjimin e pagës për periudhën prej fillimit të aktivitetit, qershor 2017, në vlerë rreth 43,000 mijë lekë.

Në mënyrë analitike, performancën e realizimit të shpenzimeve buxhetore për 4-mujorin e parë të vitit 2023, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, e gjeni të paraqitur më poshtë:

Realizimi i buxhetit sipas artikujve ekonomikë

Në mijë lekë						
Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor (plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Buxheti 4-mujor (plani)	Realizimi 4-mujor (fakti)	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	79,400	79,400	28,600	27,368	95,7 %
602+606	Shpenzime për mallra dhe shërbime, dhe fondi i veçantë	9,500	9,500	3,300	1,328	40,2 %
231	Shpenzime kapitale	1,500	1,500	0	0	0 %
	TOTALI	90,400	90,400	31,900	28,696	90%

Artikulli 600 dhe 601, “Shpenzime personeli”, buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2023, për këtë artikull është 79,400 mijë lekë, buxhet i cili duhet të mbulojë nevojat e institucionit në fushën e pagave për të gjithë vitin, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Institucioni i Komisionerëve Publikë, duke filluar nga data 9 janar 2023, ka kryer pagesat për 2 Komisionerët Publikë dhe 10 Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35/2022, me pagë referuese bazë sipas kategorisë I b (përfshirë shtesën për pozicion dhe pagën e grupit), brenda fondeve buxhetore vjetore, sipas detajimit mujor. Siç theksuam më lart, buxheti në dispozicion për vitin 2023 është miratuar dhe ka parashikuar mbulimin e shpenzimeve në paga para hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe, për rrjedhojë, nuk mbulohen të plota detyrimet për paga dhe sigurime shoqërore për institucionin, për vitin 2023. Sikurse ju kemi bërë me dije, institucioni nuk ka kryer pagesa për të mbuluar efektet financiare që rrjedhin nga rilogaritja e pagave për periudhat e mëparshme dhe në kërkesën për shtesë fondesh në këtë artikull buxhetor janë përllogaritur buxheti shtesë për vitin 2023, rreth 8,000 mijë lekë, si dhe efektet financiare për periudhat e mëparshme, në vlerë rreth 43 milionë lekë, referuar detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në total, buxheti në shpenzime personeli, detajuar për 4-mujorin e parë, ka mbuluar pagesat e pagave dhe sigurimeve shoqërore për 30 punonjës në organikë, për periudhën janar-shkurt 2023, dhe për 29 punonjës, në mars-prill 2023 (1 punonjës i larguar), si dhe për 2 punonjësit me kontratë të përkohshme. Performanca e realizimit të këtij buxheti për këtë periudhë është rreth 95.7%.

2. Artikulli 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull është 9,300 mijë lekë dhe gjatë këtij 4-mujori nuk ka pësuar ndryshime. Ky buxhet i plotëson kërkesat e institucionit hartuar në dokumentin e PBA-së 2023-2025 dhe parashikohet të mbulojë nevojat e institucionit në mallra dhe shërbime.

Performanca e realizimit të buxhetit në “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, në bazë të analizës krahasimore plan-fakt, për 4-mujorin e parë të vitit 2023, është në nivelin 40%. Theksojmë se niveli i realizimit të këtyre fondeve buxhetore kushtëzohet prej vonesave në përfundimin e procedurave të prokurimit për shkak të tërheqjes së operatorëve, ankesave etj., si dhe vështirësive në studimin e tregut. Synohet që ky nivel do të përmirësohet në periudhën pasardhëse, duke filluar që në muajin maj, kryesisht pas përfundimit të procedurës së prokurimit për blerje tonera dhe *drum-e*, e cila, për shkak të zgjatjes në kohë, nuk përfundoi në muajin prill, siç ishte parashikuar.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar disa procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël, materiale pastrimi, kancelari, si dhe procedura të thjeshtuara, blerje materiale dhe shërbime: mirëmbajtje faqe *web-i*, shpenzime larje automjeti, abonime etj.

Gjithashtu janë kryer shpenzime nga buxheti dhe janë lidhur kontrata për parkim automjeti, telefoni celular, si dhe shpenzime të zakonshme, shpenzime për energji, ujë, postë, taksat e Bashkisë etj.

Një pjesë e shpenzimeve të planifikuara do të rishikohen në vijim në kuadër të ekonomizimit të fondeve buxhetore, duke kryer rishpërndarje të tyre ose përcaktimit të prioriteteve për plotësimin e nevojave më të domosdoshme dhe më emergjente.

Në mënyrë analitike, shpenzimet operative janë realizuar si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Në mijë lekë	
		602	
		Plan	Fakt
1	Materiale e shpenzime zyre	1,656	4409
2	Shërbime nga të tretë (energji, ujë, postë, telefon, parkim etj.)	754	651
	Materiale dhe shërbime speciale	40	16
3	Shpenzime transporti + udhëtimi	360	212
4	Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme	235	
5	Shpenzime të tjera speciale	55	40
	TOTALI	3,100	1,328

3. Artikulli 231, “Shpenzime kapitale”, buxheti i miratuar për këtë artikull, për vitin 2023, është 1,500 mijë lekë, buxhet i cili tejkalon kërkesën e institucionit, paraqitur kjo në dokumentin e Projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2023-2025. Gjatë këtij 4-mujori nuk janë parashikuar blerje pajisje zyre dhe në vijim do të kërkohet rishikimi i buxhetit për vitin 2023 në shpenzime kapitale.

Vlerësojmë se buxheti i planifikuar për periudhën është zbatuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe brenda fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2023, duke plotësuar nevojat më të domosdoshme për mallra dhe shërbime.

Nëpunës Zbatues

Adelina Kastrati



Nëpunës Autorizues



Alketa Çeli



ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke



Emri i Grupit		Komisioneret Publike		Kodi i Grupit		63		
Shpenzimet e Institucionit								
Programet		(1) Fakti i vitt paraardhes Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plani i Perudhes 4 mujore /progressiv	(6) Fakti i Perudhes/progressiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
0001	Programi 03360	76,666	90,200	90,400	90,400	31,900	28,696	-3,204
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		76,666	90,200	90,400	90,400	31,900	28,696	-3,204
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit								
Totali		76,666	90,200	90,400	90,400	31,900	28,696	-3,204

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	29.5.2023		Data	29.5.2023

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit Programi	Komisionerët Publikë Veprimtaria e Komisionerit Publik	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Plan 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar viti korrent 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishtikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhës 4 muajore /progresiv	Kodi i Grupit Kodi i Programit (6) Fakti i Periudhës/progresiv	63 03360 (7)=(6)-(5) Diferenca
Art.	Emertimi							
600	Paga	63,571	70,300	70,300	70,300	25,560	24,838	-722
601	Sigurime Shoqërore	7,004	9,100	9,100	9,100	3,040	2,530	-510
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,728	9,300	9,300	9,300	3,100	1,328	-1,772
603	Subvencione							0
604	Transferita Korente të Brendshme							0
605	Transferita Korente të Huaja							0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,931		200	200	200		-200
Non-Totali	Shpenzime Korrente	76,234	88,700	88,900	88,900	31,900	28,696	-3,204
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	432	1,500	1,500	1,500			0
232	Transferita Kapitale							0
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	432	1,500	1,500	1,500	0	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferita Kapitale							0
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	432	1,500	1,500	1,500	0	0	0
	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti							0
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		76,666	90,200	90,400	90,400	31,900	28,696	-3,204

Nepunësi Zbatues	Emri	Adelina Kastri	Kordinatori i GMS/Nepunësi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	29.5.2023		Data	29.5.2023

ANEXSI nr.3 "Raporti përmblledhës i realizimit të kërkesave të performancës/produkteve të programit"

Emri i Grupit	Komisionet Publike	63
Programi	Vepërimitaria e Komisionerit Publik	3360

Kodi	Emertimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Mësimi mësim	Sasia Faktike (sipas vitit 2022)	Shpenzimet (sipas vitit 2022)	I			II			III			IV	Luhatjet në Koston për Mjesi		
					Kosto për Mjesi (sipas vitit 2022)	Sasia (sipas planit të vitit 2023)	Shpenzimet (sipas planit të vitit 2023)	Kosto për Mjesi (sipas planit të vitit 2023)	Sasia (sipas planit të vitit 2023)	Shpenzimet (sipas planit të vitit 2023)	Kosto për Mjesi (sipas planit të vitit 2023)	Sasia Faktike për 4 mujorin e vitit 2023	Shpenzimet Faktike për 4 mujorin e vitit 2023		Kosto për Mjesi për 4 mujorin e vitit 2023	V = IV - I	V = IV - II
Produkti 1	Numer Çështjesh të njoftuara nga KPPK, të shqyrtuara nga Komisionerët Publike brenda atëvite ligjore	nr. Çështjesh	109	76,234	699	130	88,900	684	130	88,900	684	50	28,696	574	-18%	-16%	-16%
Produkti 2	Pajisje komp./mobile/pajisje zyrc	site pune	7	432	62	6	1,500	250	6	1,500	250	0	0				
Totali				76,696	761	136	90,400	934	136	90,400	934	50	28,696				

Nepunësi Zbatues	
Emri	Adelina Kastrioti
Firma	
Data	29.5.2023

Kordinatori i GMS/Nepunësi Autorizues	
Emri	Alketa Çeli
Firma	
Data	29.5.2023

ANEXSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"
 Përfudha e Raportimit: 4 majori 2023

Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit: Veprimtaria e Komisionit Publik								Komente
Qelimi 1	Procesi i Rivleresimit te gjyqtareve dhe prokurorëve ne Republikën e Shqipërisë ka per qellim garantimin e funksionimit te shtetit te drejte, pavarësisht e sistemit te drejtësisë si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi									
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2022	Niveli i planifikuar ne vitin 2023	Niveli i rrishtuar per 4 mujorin e vitit 2022	Niveli faktik per 4 mujorin e vitit 2023	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit		
Objektivi 1.1	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te rivleresimit, respektimi i parimit te pavarësisht dhe pavarësisht, procesit te regullit ligjor, transparencës dhe frymës se bashkëpunimit ndërmjet dy komisionerëve publike. Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera."									
	Numer Cështjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisionet Publike brenda atateve ligjore	A	Shqyrtim i vendimeve te njoftuara nga KPK	109	130	130	50	38%		

Nepunesi Zbatues		Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	
Emri	Adelina Kastrati	Emri	Alketa Çeli
Firma		Firma	
Data	29.5.2023	Data	29.5.2023

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxheti vit 2023	Realizimi Progresiv nga fillimi i vitit 2023	Realizimi për periudhën e raportimit vjetor	Realizimi Progresiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	-				650			-	
M630013	Pajisje kompjuterike	-				850			-	
TOTALI		-			-	1,500			-	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrioti	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	29.5.2023		Data	29.5.2023